VENDIM
Nr.297, datë 15.4.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, PËR PRONAT E PËRCAKTUARA NË VENDIMIN NR.448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Zëvendëkryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pronat e përcaktuara në vendimin nr.448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama